

VENDIM
Nr. 177, datë 20.8.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 187, DATË 10.11.2017, “Për LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; i ndryshuar, nenit 3, pika 50; nenit 22, pika 2, germet “a” dhe “b”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; nenit 4, pika 1, germet “a” dhe “b”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga drejtoritë teknike për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 10.11.2017, licencoi shoqërinë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

- Sa më sipër, shoqëria “Albgaz” sh.a. brenda një afati 6-mujor në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kishte detyrimin për të plotësuar të gjithë dokumentacionin e munguar si më poshtë:

- dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar;

- lejet dhe autorizimet mjedisore;

- një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri), që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit në kuadër të licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD;

- plan biznesi;

- volumet e projektuara ditore për t’u përpunuar sipas vlerësimeve të aplikantit;

- programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit,

- programi i parashikuar i mirëmbajtjes së sistemit të shpërndarjes;

- sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t’u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

- Në vijim të sa më sipër, ERE, me shkresën nr. 521/10 prot., datë 23.11.2017, bëri me dije shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimmarrjen e sipërcituar, mungesën e dokumentacionit dhe kushteve të vendosura në dispozitivin e vendimit për plotësimin e dokumentacionit të munguar brenda afateve të përcaktuara.

- Në përgjigje të korrespondencës sipërcituar të ERE-s, shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën nr. 38/1, datë 14.5.2018, ka informuar ERE mbi përditësimin e procedurave të dokumentacionit si më poshtë:

- pajisja me certifikatë pronësie (Sheq i Madh, Fier–Drizë, Fier–Gjonçë, Lavdan);

- procedurat në vijimësi për certifikatat në Cërrik, Drenovë dhe Balldren.

- Sa më sipër, “Albgaz” sh.a. informon ERE se ka bërë kërkesë pranë ZVRPP-së përkatëse, në mënyrë që të bëhet e mundur ecja me ritme sa më të shpejta në procesin e regjistrimit të aseteve. Gjithashtu, me qëllim plotësimin e dokumentacionit, “Albgaz” sh.a. ka aplikuar për transferim të lejes mjedisore (tip A) nga “Albpetrol” tek “Albgaz”, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe është ndërkohë në pritje.

- “Albgaz” sh.a. bën me dije, gjithashtu, se po merr të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e kërkesave të vendimit 187, datë 10.11.2017, pavarësisht ndryshimeve në drejtimin e shoqërisë, si dhe

strukturave të ministrive nga të cilat ka varësi ky subjekt.

- ERE, me shkresën nr. 439 prot., datë 13.6.2018, i është drejtuar shoqërisë “Albgaz” sh.a., duke kërkuar depozitimin brenda datës 18.6.2018, të të gjithë dokumentacionit të munguar, në kuadër të përmbushjes së detyrimit që buron nga ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, të Bordit të ERE-s.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 495 prot., datë 6.7.2018, ka përcjellë kërkesën për ndryshimin e afatit 6-mujor, të vendosur në pikën 1 të vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, për plotësimin e dokumentacionit të munguar, deri në datën 20.12.2018, për arsyet e sipërcituara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 187, datë 10.11.2017, “Mbi licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, me përmbajtje: “1. Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda afatit 6-mujor në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar ...” ndryshon dhe bëhet: “1. Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2018, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar.....”

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të përcjellë këtë vendim pranë “Albgaz” sh.a. dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti